



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 7835

NR. VENDIMI 6655

**VENDIM**

**“NE EMER TE REPUBLIKES”**

*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :*

**Gjyqtar : ERVIN POLLOZHANI**

asistuar nga sekretare gjyqesore **Lusjana Fezollari**, sot më datë **18. 07. 2017**, mori në shqyrtim në seancë gjyqesore publike, çështjes civile me **Nr. 7835 Regj. Themeltar** që i përket :

**PADITese:**

**SHOQERIA \*\*\***, shoqeri aksionere e organizuar dhe qe ushtron veprimtarine e saj sipas legjislacionit turk, me seli ne: **\*\*\***, e perfaqesuar ne gjykim me prokuren e dt. **\*\*\* nga znj. \*\*\***

**IPADITUR:**

**\*\*\*» - \*\*\***, me NIPT **\*\*\*** dhe me emer tregtar **\*\*\***, me adrese **\*\*\***, i mbrojtur vet ne gjykim.

**PERSON I TRETE:**

**DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONESISE INDUSTRIALE**, me adrese Bulevardi « Zhab D'Ark » prona Nr. 33, Shtepia e Ushtarakeve Tirane, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim perfaqesimi Nr. **\*\*\* Prot. dt. 15. 06. 2017 nga znj. \*\*\***.

**OBJEKTI:**

Në kuadër të konkurrencës se pandershme kërkojmë detyrimin e të paditurit **\*\*\***, njohur me emrin tregtar **\*\*\*\*** :

- Të ndërpresë aktivitetin e prodhimit të produkteve me markë tregtare **\*\*\*\***;
- Të ndërpresë aktivitetin e shpërndarjes së produkteve në treg me markën **\*\*\*\***;
- Të ndalojë perdorimin e markës **\*\*\*\*** në veprimtarine tregtare;
- Të heq nga tregu dhe të bllokoje shpërndarjen e metejshme të produkteve që ekzistojne aktulisht me markën **\*\*\*\*** dhe të prodhuara nga i padituri;
- Publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në

median publike me shpenzimet e të paditurit;  
- Detyrimin e të paditurit të heqë dore nga kërkesa për të fituar të drejta industriale mbi markën "\*\*\*";  
si dhe percaktimin e statusit të markës si "Markë e Mirënjohur".

**BAZA LIGJORE:**

Neni 6 bis i Konventes se Parisit. Nenet 143, 184/a, 184/b te ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar. Nenet 638, 639 të Kodit Civil. Neni 348 i K. Pr. Civile.

Gjykata, pasi administroi provat shkresore, degjoi pretendimet perfundimtare te perfaqesueses se pales paditese, e cila kërkoi: *Pranimin e kerkese padise sipas objektit te saj*, te paditurin qe kerkoi: *Rrezimin e kerkese-padise si te pa bazuar ne prova dhe ne ligj*, perfaqesuesen e personit te trete qe: *E la zgjidhjen e kesaj ceshtjeje ne çmim te gjykates*, pasi e shqyrtoi çeshtjen ne teresi, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor,

**VEREN :**

Se, paditesi shoqeria \*\*\*, nepermjet perfaqesueses se saj me prokure i është drejtuar kesaj gjykate, me kërkesë-padine me objektin e siperpermendur.

Nga ana e saj gjykata kryesisht ne referim te Nenit 193 te K. Pr. Civile thirri me cilesine e personit te trete Drejtorine e Pergjithshme te Pronesise Industriale, ne kushtet kur kjo drejtori, referuar shkakut ligjor te padise dhe objektit te saj, terhiqte interesa ne kete gjykim.

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kesaj ceshtjeje te paraqitur per gjykim dhe bazuar ne Nenet 36, 59 te K. Pr. Civile, konstatoi se çeshtja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil.

Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë të Nenin 41 të K. Pr. Civile : ”*Në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera*”. Meqënëse ndodhemi përpara një mosmarrëveshjeje me karakter tregtar që rrjedh nga marrëdhënia juridiko – tregtare e pronësive mbi markat, gjykata referuar dhe Neneve 334-335 te K. Pr. Civile çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencen tokesore ne bazë të Nenit 43 të K. Pr. Civile, “*Kur i padituri eshte person juridik paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku i padituri ka qendren e tij...*”. Nga ana tjetër neni 348 i K. Pr. Civile percakton se : «*Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjot tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëveshjeve tregtare në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod*”.

Sa me siper, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane per shqyrtimin e kesaj çeshtjeje objekt konflikti.

Pala paditese, bazuar ne Nenin 32/a te K. Pr. Civile legjitimohet t'i drejtohet gjykates me kete kerkese-padi ne baze te se ciles do te perfitoje te drejta personale - pasurore.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të Neneve 71, 72 dhe 73 të K. Pr. Civile, çmoi se

nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palet prezent në gjykim.

Në bazë të nenit 35 të K. Pr. Civile gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

*Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se :*

Paditesi, shoqëria \*\*\* është një shoqëri tregtare e së drejtës turke, e cila si objekt të veprimtarisë së saj tregtare ndër të tjera ka edhe *tregtimin me shumicë dhe pakicë të produkteve industriale.*

Nga ana tjetër \*\*\*-\*\*\* është subjekt i së drejtës tregtare shqiptare dhe ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e tij në dt. \*\*\* dhe si objekt të veprimtarisë së tij ndër të tjera ka dhe *“prodhim dhe shitje të detergjenteve”*. Sipas ekstraktit të QKB-së, emri tregtar i këtij subjekti tregtar është *“\*\*\*\*”*.

Rezulton se pala paditese ka në pronësi të saj markën tregtare të regjistruara *“\*\*\*\*”* (fjalë dhe vizatim), me regjistrim nderkombëtar Nr. \*\*\* dt. 12. 03. 2017 pranë WIPO dhe është e regjistruar në Klasën 3 dhe 5 të Nices me përshkrimin *“detergjente, zbardhues rrobash, eliminues njollash, zbutës rrobash, etj. ...preparate farmaceutike”*.

Krahas kësaj kjo markë origjinale e saj e ka në Turqi ku dhe ka regjistrimin kombëtar si të tillë si fjalë standarte që prej datës 07. 12. 2005 për mallrat e klasës 3, 5 dhe 16, fakt ky që u provua në gjykim nëpërmjet kopjes së çertifikatës së regjistrimit të markës, lëshuar nga "Instituti i Patentave në Turqi". Numri unik i regjistrimit të kësaj markë është \*\*\*. Veç këtij regjistrimi, kompania \*\*\*, në Turqi ka të drejtë industriale edhe për përfaqësimin e markës (logon) *“\*\*\*\*”* nga data 29. 01. 2014 për mallrat e klasës 3, fakt ky që vërtetohet nga kopja e çertifikatës së regjistrimit të markës lëshuar nga "Instituti i Patentave në Turqi". Numri unik i këtij regjistrimi të markës \*\*\* si "fjalë dhe figurë" është \*\*\*.

Po kështu sipas pohimit gjyqësor të palës paditese, marka *“\*\*\*\*”* është e regjistruar edhe në shtetin e Irakut si dhe produktet nën këto markë shiten edhe në shtete të tjera si Azerbajxhan, Turkmenistan, Egjipt, Butan, Jordani, Siri.

Nga interesimi kryesisht i palës paditese pranë personit të tretë por dhe nga informacionet e siguruar prej saj, pala paditese ka ardhur në dijeni të faktit se i padituri, ka depozituar me datë 26. 07. 2016 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësive Industriale, kërkesën për regjistrimin e markës *“\*\*\*\*”* -fjalë dhe figurë, për listen e mallrave të klases 3 sipas Klasifikimit Nderkombëtar të Nices, në emër të tij.

Pas këtij aplikimi, nga personi i tretë është bërë publikimi i këtij aplikimi në Buletinin e Pronësive Industriale Nr. \*\*\* dt. 03. 10. 2016. Referuar Nenit 152/1 të ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 me ndryshimet që lidhet me afatin maksimal për të bërë kundështimin, prej 3-muajsh, pala paditese ka bërë kundështimin përkatës pranë personit të tretë me pretendimin se i padituri nuk është pronar i markës *“\*\*\*\*”* dhe se nëpërmjet këtij aplikimi ky i paditur po zhvillon konkurrencë të pandershme duke prodhuar dhe shpërndarë produkte të markës *“\*\*\*\*”* si dhe duke kërkuar pranë DPPI, të drejta industriale mbi këto markë.

Nga ana e personit të tretë një kërkesë e tillë është refuzuar me pretendimin se pala paditese; *nuk gezon të drejta industriale të mëparshme në Shqipëri si rezultat i regjistrimit të markës në përputhje me ligjin Nr. 9947/2008; nuk është aplikanti dhe nuk është pronari i një*

marke te meparshme “\*\*\*” te depozituar ne DPPI; nuk eshte pronari i emrit tregar brenda territorit te RSH-se; nuk ka te drejte autori, etj.

Nisur nga kjo situatë për shkak të mos zgjidhjes së çështjes në rrugë administrative, pala paditese i është drejtuar gjykatës me këtë kërkesë-padi me objekt, ndergjyqesi dhe shkakun ligjor të sipërpermendur.

### Pretendimet e pales paditese

Sipas pretendimeve të shprehura në gjykim dhe në konkluzionet përfundimtare përfaqësuesja e pales paditese parashtroj se, kjo markë e cila kërkohet të regjistrohet nga i padituri në emrin e tij, është identike në emërtim dhe figurë me markën “\*\*\*” që prodhohet nga kompania \*\*\* dhe tregtohet në Shqipëri që prej datës 16. 01. 2010 për të njëjtat produkte të klases 3 sipas klasifikimit ndërkombëtar të Nicës.

Sipas pales paditese u parashtrohet se marka në fjalë është shumë e suksesshme dhe e mirënjohur jo vetëm në Turqi por edhe në rreth 80 shtete të tjera të Europës, Azisë dhe Australisë. Nder markat me të suksesshme që “\*\*\*” prodhon dhe tregon në Turqi dhe në 80 shtete të tjera të Europës, Azisë dhe Australisë janë: “\*\*\*”, “\*\*\*” dhe “\*\*\*”. Marka “Peros” është e regjistruar nëpërmjet sistemit të Madridit në 48 shtete në të cilat përfshihet edhe Shqipëria; marka “\*\*\*” është e regjistruar vetëm në 11 shtete duke përfshirë edhe Shqipërinë; ndërsa marka “\*\*\*” është e regjistruar në Turqi nëpërmjet zyres shtetërore kompetente “Instituti i Patentave në Turqi” dhe në Irak nëpërmjet “Zyres së Patentave dhe Markave”.

Produktet me markën “\*\*\*” shiten në Shqipëri që prej muajit janar të viti 2010 nga kompania “\*\*\*” sh.p.k. e autorizuar për shpërndarjen dhe tregtimin e tyre nga “\*\*\*”. Përfaqësimi i markës (logo) që përdoret në ambalazhimin e këtyre produkteve është imazhi në vijim.

\*\*\*

Ashtu siç mund të dallohet qartë edhe nëpërmjet krahasimit të dy imazheve të vendosura me poshtë, marka “\*\*\*” dhe përfaqësimi i markës “\*\*\*” (logo) që “\*\*\*” pretendon se është pronar i saj, nëpërmjet kërkesës për regjistrim marke depozituar me datë 26.07.2016 pranë personit të tretë, është *identike* me markën “\*\*\*” dhe përfaqësimin e markës “\*\*\*” (logo) që shoqëria “\*\*\*” tregon në Shqipëri prej datës 16. 01. 2010.

\*\*\*

\*\*\*

\*\*\*

Në logon e shoqërisë “\*\*\*” është dhe një fjalë e shkruar me madhësi shkrimi të vogël “\*\*\*” dhe në shqip përkthehet “e re”. Kjo është një fjalë e përgjithshme që shërben për të përshkruar produktin, ndaj “\*\*\*” nuk mund të mbrohet dhe rrjedhimisht nuk është element i markës “\*\*\*”.

Duke marrë parasysh datën kur “\*\*\*” ka filluar të jetë pjesë e tregut shqiptar dhe

daten kur "\*\*\*\*" eshte regjistruar prane "QKB"-se, rezulton se \*\*\* operon me heret ne tregun shqiptar me nje periudhe kohore me te hershme prej 3 vitesh e 5 muajsh. Meqenese i vetmi informacion qe disponohet ne lidhje me kohen kur "\*\*\*\*" ka ngritur pretendimet per te drejta mbi marken "\*\*\*\*" eshte data e depozitimit te kerkeses per regjistrimin e markes prane DPPM, konkretisht 26. 07. 2016, sipas paditesit arsyetohet se kjo diference ne kohe mund te jete shume me e madhe se 3 vjet e 5 muaj.

Fakti qe "\*\*\*\*" operon ne tregun shqiptar me heret se "\*\*\*\*" me nje diference kohore prej te pakten 3 vjet e 5 muaj, tregon se produktet "\*\*\*\*" te prodhuara dhe tregtuara nga "\*\*\*\*", kane patur sukses ne treg dhe marka "\*\*\*\*" ka krijuar nje emer te mire dhe ka nje reputacion ne Republiken e Shqiperise. Per kete arsye i padituri, synon te perfitoje ne menyre te qellimshme, me paramendim dhe te padrejte nga reputacioni i mire i markes "\*\*\*\*" te hedhur ne tregun shqiptar qe prej janarit te vitit 2010 nga kompania turke.

Kohezgjatja ne treg, sukcesi ne treg dhe shtrirja gjeografike qe kane produktet "\*\*\*\*" te prodhuara nga "\*\*\*\*" jane arsytet mbi te cilat paditesi ngre pretendimet se marka "\*\*\*\*" ka krijuar dallueshmeri ne treg dhe gezon te drejtat per te marre statusin si "Marke e Mirenjohur" nga konsumatori shqiptar.

Gjithashtu, nisur nga pretendimi se marka "\*\*\*\*" eshte "Marke e Mirenjohur" ne Shqiperi dhe mbeshtetur ne ligjin Nr. 9947, dt. 07. 07. 2008, "Per pronesine industriale", i ndryshuar, neni 184/a, pika 1, germa 9), paditesi ka kerkuar ne gjykate per te vendosur kjo e fundit ne lidhje me statusin e markes "\*\*\*\*" si "Marke e Mirenjohur" dhe per shkeljen e te drejtave te kesaj marke, te fituara si rezultat i statusit si "Marke e Mirenjohur".

Paditesi ka sjell produktet e tij me marken "\*\*\*\*" ne tregun shqiptar qe ne date 16. 01. 2010. Ky fakt vertetohet nga marreveshja e bashkepunimit midis shoqerise "\*\*\*\*" dhe kompanise "\*\*\*\*" sh.p.k., e nenshkruar ne kete date. "\*\*\*\*" sh.p.k. eshte kompani e autorizuar nga shoqeria "\*\*\*\*" per shperndarjen dhe shitjen e produkteve te saj me marken "\*\*\*\*", brenda territorit te Republikes se Shqiperise dhe vazhdon te jete distributor i autorizuar nga "\*\*\*\*" dhe kjo vertetuar nga nje tjetër marreveshje bashkepunimi firmosur mes dy paleve me date 16. 01. 2016.

Pervec marreveshjes se bashkepunimit, ekzistencen e produkteve \*\*\* ne Shqiperi e provojne edhe faturat e shkembjera midis "\*\*\*\*" dhe "\*\*\*\*" sh.p.k. qe prej vitit 2010.

Marka "\*\*\*\*" dhe perfaqesimi i saj (logo) qe perdoret nga \*\*\* eshte e njejte me marken "\*\*\*\*" te "\*\*\*\*" dhe te dy markat perdoren per te tregtuar te njejtat produkte ne tregun Shqiptar. Per shkak te njellojshmerise ne emertimin e markes, njellojshmerise ne perfaqesimin e markes dhe njellojshmerise ne llojin e produkteve qe tregtojne ne te njejtin treg, ashtu siç citohet edhe ne nenin 638 te Kodit Civil, pika 1, ekziston mundesia e shkakimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken qe prodhohet nga \*\*\*. Shitja e te njejtit lloj produkti me te njejten marke, prodhuar nga dy kompani te ndryshme ngaterron konsumatorin ne lidhje me origjinen tregtare te produktit.

Produktet e prodhuara nga kompani te ndryshme me marke te njejte nuk nenkupton qe keto produkte jane prodhuar ne te njejtat kushte laboratorike dhe standarte teknologjike. Rrjedhimisht duke mos perdorur te njejtat kritere dhe standarte prodhimi, cilesia e produkteve nuk mund te jete e njejte. Ne kete menyre, konsumatori mund te bleje nje

produkt me origjine tregtare te gabuar dhe ne kete rast ekziston mundesia per tu zhgenjuar nga cilesia e produktit.

Perpjekjet e "\*\*\*\*" per te fituar te drejta industriale, nepermjet kerkese per regjistrimin e markes "\*\*\*\*", tregojne qarte se \*\*\* ne menyre te drejteperdrejte po tenton te legjitimoje si prone te veten marken dhe cilesine e produkteve nen emrin "\*\*\*\*" .

Nga sa u shenua me lart konkludohet qe: "\*\*\*\*" po zhvillon nje kokurrence te pandershme me paramendim si dhe duke kerkuar mbrotjen e te drejtave industriale per marken "\*\*\*\*", synon te demtoje kompanine "\*\*\*\*", te demtoje natyren dalluese te produkteve dhe reputacionin e mire qe kjo kompani ka fituar ne tregun shqiptar nepermjet produkteve te saj me marken "\*\*\*\*".

Ne te njejten kohe, mbeshtetur ne nenin 6 bis te Konventes se Parisit, paditesi pretendon se kompania "\*\*\*\*", ka pasur dhe vazhdon te kete te drejta te meparshme mbi marken "\*\*\*\*" si "marke e mirenjohur" brenda territorit te Republikes se Shqiperise ne daten kur "\*\*\*\*" ka aplikuar prane DPPM per te drejta industriale mbi marken "\*\*\*\*". Me termin "te drejta te meparshme" referohet fakti qe marka "\*\*\*\*" ekzistonte ne tregun Shqiptar qe prej janarit te vitit 2010 me origjine tregtare kompanine turke "\*\*\*\*" dhe ne daten e aplikimit per regjistrim te markes "\*\*\*\*" ne emer te aplikantit "\*\*\*\*", pretendohet se kjo marke ishte dhe vazhdon te jete e mirenjohur ne Republikën e Shqiperise, ne kuptim te nenit 6 bis te Konventes se Parisit (cituar me poshte), te publiku i sektorit perkates, si rezultat i perdorimit, perfaqesimit, publikimit dhe reklamimit.

Konventa e Parisit "Per mbrotjen e Pronesise Industriale" eshte miratuar ne Paris me 20 Mars 1883 dhe ka hyre ne fuqi ne Shqiperi me 4 Tetor 1995. Neni 6 bis i Konvetes se Parisit citon se: *" 1. Shtetet e Unioni marrin persiper per shkak te detyres nese legjislacioni i tyre e lejon ose me kerkese te pales se interesuar te refuzojne ose te anullojne regjistrimin dhe te ndalojne perdorimin e nje marke qe konsisiton ne riprodhim, imitim ose perkthim me qellim qe te shkaktoje konfuzion te nje marke qe konsiderohet nga autoritetet kompentente te shtetit e regjistruar ose e mirenjohur ne ate shtet ne emer te nje personi qe gezon te drejta sipas kesaj konvente dhe perdoret per mallra identike apo te ngjashme. Keto dispozita aplikohen edhe kur pjesa esenciale e nje marke konsisiton ne riprodhim te nje marke te mirenjohur ose ne imitim me qellim te krijoje konfuzion ne lidhje me te".*

Aktualisht ligji Nr. 9947 "Per mbrotjen e Pronesise Industriale" nuk percakton kriteret mbi vleresimin e nje marke si "marke te mirenjohur". Ne mungese te percaktimit me ligj te ketyre kriterëve sygjerohet per shtetet antare te WIPO dhe te Konvetes se Parisit, te perdoren disa rekomandime te hartuara nga Asambleja e Konventes se Parisit "Per mbrotjen e Pronesise Industriale" dhe nga Asambleja e Pergjithshme e Organizates Boterore per Pronesine Intelktuale (WIPO).

Shqiperia eshte antare e Organizates Boterore te Pronesise Industriale (WIPO) qe prej dates 30 Qershor 1992 dhe anetare e Konventes se WIPO nepermjet Ligjit Nr. 8993, date 30. 01. 2003 *"Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne "Konventen per themelimin e Organizates Boterore te Pronesise Intelktuale"* .

Pretendimi i paditesit, mbi statusin e markes "\*\*\*\*" si "Marke e Mirenjohur" ne Republikën e Shqiperise , mbeshtetet ne suksesin qe ajo ka pasur ne treg, ne karakterin dallues ne krahasim me produktet e tjera te te njejtit lloj, numerin e madh te shitjeve nder

vite, ne shtrirjen gjeografike te shitjeve si dhe ekzistencen e gjate ne treg.

Pretendimet per konkurrence te pandershme:

Pretendimet e kompanise "\*\*\*\*" per konkurrence te pandershme, ne lidhje me prodhimin dhe tregtimin e mallrave te klases 3 sipas klasifikimit Nderkombetar te Nices, brenda te territorit te republikes se Shqiperise, iniciuar nga i padituri, ngrihen bazuar ne faktin se marka "\*\*\*\*" e prodhuar nga "\*\*\*\*" ekziston ne tregun Shqiptar shume vite me heret nga momenti qe "\*\*\*\*" ka kerkuar te drejta industriale mbi kete marke si dhe shume vite me heret se \*\*\*-person fizik te regjistronte aktivitetin e tij tregtar me emer tregtar "\*\*\*\*", ne QKB.

Nisur nga sa me siper, lind dyshimi i arsyesshem se "\*\*\*\*" ka pasur dijeni mbi ekzistencen e markes "\*\*\*\*" ne Shqiperi dhe suksesin e saj ne tregun shqiptar. Meqenese marka "\*\*\*\*" dhe perfaqesimi i saj (logo) qe perdoret nga \*\*\* eshte e njejte me marken "\*\*\*\*" te "\*\*\*\*" dhe te dy markat perdoren per te tregtuar te njejtat produkte ne tregun Shqiptar, ekziston mundesia e shkaktimit te konfuzionit te publiku mbi origjinen tregtare, cilesine dhe vertetesine e produkteve. Ne keto kushte sipas paditesit arrihet ne perfundimin se "\*\*\*\*" me qellim qe te perfitoje nga: -reputacioni i mire dhe suktesi i markes "\*\*\*\*", -emri i mire i shoqerise "\*\*\*\*", -besimi i konsumatorit mbi cilesine e mallrave "\*\*\*\*", ka bere perpjekje per te fituar te drejta industriale mbi kete marke duke kerkuar regjistrimin e marke ne pronesi te tij.

Fakti qe "\*\*\*\*" ka kerkuar te fitoje te drejta industriale prane DPPI mbi marken "\*\*\*\*" dhe bazuar ne fushen e veprimtarise "*Prodhim shitje detergjente. Shitje artikuj le ndryshem*" te aktivitetit te tij regjistruar prane QKB, lind dyshimi qe "\*\*\*\*" eshte duke perfitur edhe monetarisht nga prodhimi dhe shitja e produkteve me marken "\*\*\*\*". Gjithashtu cilesia e produkteve te prodhuara dhe tregtuara nga "\*\*\*\*" nuk eshte e njejte me ate te produkteve qe prodhuara dhe tregtuara nga "\*\*\*\*", pasi nuk perdoren te njetat kushte laboratorike dhe standarte teknoogjike ne procesin e prodhimit te produktit.

Keto veprime te ndermarra nga ana e "\*\*\*\*" ndikojne negativisht : -*duke prishur imazhin e mire te mallrave me marken "\*\*\*\*", -duke demtuar dallueshmerine e produkteve "\*\*\*\*" ne treg, -duke ngaterruar konsumatorin mbi origjin tregtare te produkteve, -duke prishur reputacionin e mire te shoqerise "\*\*\*\*" ne treg, -duke demtuar veprimtarine e shoqerise "\*\*\*\*" ne Shqiperi dhe rrjedhimisht edhe veprimtarine e kompanise distributore "\*\*\*\*" sh.p.k.*

Te gjitha sa me lart provojne se veprimtaria dhe veprimet e "\*\*\*\*" plotesojne te gjitha kushtet e kerkuara nga neni 638 i Kodit Civil, per zhvillimin e konkurrences se pandershme.

Nje argument tjetër eshte se pala e paditur eshte ne konflikt dhe me shume shoqerie te tjera qe operojne ne tregun shqiptar per te njejtat shkaqe si dhe paditesi duke qene se ka bere aplikime prane personit te trete per regjistrim te disa markave ne emer te saj.

Shkalla e njohurive ose e njohjes se markes ne sektorin publik perkates.

Marka "\*\*\*\*" prodhuar nga shoqeria "\*\*\*\*" dhe shperndare nga kompania "\*\*\*\*"

sh.p.k. tregtohet ne dyqanet dhe supermarketet e qyteteve te ndryshme ne Republiken e Shqiperise qe prej vitit 2010. Ky eshte nje fakt qe vertetohet nga "faturat tatimore te shitjes midis \*\*\*\*" sh.p.k. me dyqanet dhe supermarketet ne qytete te ndryshme te Shqiperise. Nga faturat tatimore, verehet se gjate kesaj periudhe gjashte vjeçare, numri i shitjeve te ketyre mallrave dhe sasia ne njesine matese kilogram ka ardhur duke u rritur me kalimin e kohes dhe se shtrirja gjeografike e ketij produkti ka ardhur duke u zgjeruar.

Konkretisht, bazuar ne shkresen e administratorit te kompanise \*\*\*\*" sh.p.k, rezulton se vetem gjate vitit 2016 : -detergjenti pluhur \*\*\* eshte shitur ne sasine 418.732 kg, -xhel enesh \*\*\* eshte shitur ne sasine 545.336 kg, -leng xhami \*\*\* eshte shitur ne sasine 14.963 kg -detergjent leng \*\*\* eshte shitur ne sasine 20.896 kg.

Sasite e shenuar me lart jane ne nivele te larta, duke pasur parasysh se ne treg ekzitojne edhe shume marka te tjera qe ofrojne te njejtat lloje produktetesh.

Ekzistenca e mallrave me marken \*\*\*\*", ne tregun shqiptar ne shtrirje kohore prej gjashte vitesh eshte nje tregues i mire qe kjo marke eshte mirepritur dhe pranuar gjeresisht nga konsumatori shqiptar dhe vet marka ka fituar karakter dallues ne krahasim me mallrat e tjera te te njejtat lloj.

#### Kohezgjatja, perhapja dhe zona gjeografike e perdorimit te markes

Kohezgjatja, perhapja dhe zona gjeografike e çdo lloj perdorim te markes jane tregues shume te pershtatshem, per te percaktuar nese nje marke eshte e mirenjohur ose jo nga sektori publikut perkates. Gjithashtu, perdorimi i markes ne territoret fqinje, ne territoret ne te cilat flitet e njejtat ose fliten te njejtat gjuhe, ne territoret te cilat jane te mbuluara nga e njejtat media (televizioni ose shtypi i shkruar) ose ne territore te cilat kane marredhenie te ngushta tregtare, mund te sherbeje si tregues i vlefshem per vendosjen e statusit te kesaj marke si marke e mirenjohur.

Kompania \*\*\*\*" sh.p.k. e autorizuar si kompania e vetme ne Shqiperi, me te drejten per te shperndare mallrat e marken \*\*\*\*" te prodhuara nga \*\*\* si dhe me te drejten per te tregtuar keto mallra, ushtron keto te drejta te specifikuara nga "Merreveshja per disitributor te autorizuar" te nenshkruar midis dy kompanive ne fjale, qe ne daten 16. 01. 2010. Kjo marreveshje eshte rinovuar ne 16. 01. 2016 nepermjet te ciles kompania \*\*\*\*" sh.p.k. vazhdon te kete te drejten per te shperndare dhe tregtuar produktet me marken \*\*\*\*" te prodhuara nga \*\*\*\*".

Mallrat me marken \*\*\*\*" shiten edhe ne Kosove, Maqedoni dhe shume shtete te tjera veç Turqise, nepermjet kompanive distributore perkatese. \*\*\* eshte nje shoqeri shume e sukseshme ne Europe, Azi dhe Australi dhe ka arritur te kete krijoj reputacionin e saj dhe karakterin dallues mes shume markave te tjera qe ekzistojne ne treg.

#### Vlerat e markes

Ne pergjithesi, vlera e nje marke eshte e bazuar direkt ne fuqine e saj per te fituar te ardhura. Perverc kesaj, studimet e industrise ne te cilen marka eshte (ose do te) perdoret, sondazhet e tregut te cmimeve te mundshme te shitjes dhe fitimeve te pritshme, si dhe opinionet e eksperteve te industrise mund te perdoren per te treguar vleren e markes.

Vlera e nje marke tregtare qendron ne emrin e mire lidhur me ate marke. Emri i mire eshte nje aset jo-material qe perben nje pjese te vleres se biznesit te pronarit te markes



tregtare. Ne shume raste, percaktimi i emrit te mire te markes mund te jete mjaft e veshtire, per shkak te shume faktoreve qe duhet te konsiderohen. P.sh, arsyetimi i njerezive mund te ndryshoje ne varesi me pritshmerite e ardhshme ose ngjarje te papritura, te tilla si mundesite per rritjen e vleres se markes tregtare dhe kercenimi nga konkurreuca e larte dhe rreziqet e tjera te tregut qe kercenojne nje marke.

Nje metode me e zakonshme per te vleresuar nje marke eshte metoda e te ardhurave, e cila cakton nje vlere per nje marke tregtare bazuar ne te kaluaren dhe fitimet e ardhshme qe pritet te sigurohen lidhur me shenjen.

#### Pretendimet e te paditurit:

I padituri nga ana e tij prapsoi se kerkese-padia duhet te rrezohet si e tille pasi qe eshte e pa bazuar ne ligj dhe ne prova. Veprimet e pales paditese kerkojne qe aktiviteti ligjor i DPPI te suprimohet si institucioni kompetent kombetar per mbrojtjen e Pronesise Industriale.

\*\*\* nuk ka asnje te drejte mbi marken \*\*\* ne territorin e Republikes se Shqiperise. Te drejtat e tyre mbi marken “\*\*\*” jane ne Turqi dhe nuk gezojne asnje mbrojtje ne Shqiperi.

Pala paditese nuk paraqiti asnje prove administrative per te vertetuar se ata (\*\*\*) te kene kerkuar regjistrimin e markes \*\*\* prane DPPI. Pra nuk ekziston asnje fakt qe mund te perbeje objektin e padise kunder \*\*\*.

Pala paditese nuk e argumentoi asnjehere te vetme "paligjshmerine" e veprimeve te te paditurit sikurse nuk argumentoi asnjehere te vetme se Institucioni i vetem qe ka te drejten e Regjistrimit te Markave ne teritorin e Republikes se Shqiperise qe eshte DPPI, te kete gabuar.

#### Arsyetimi i gjykates

Nga ana e saj gjykata referuar objektit dhe bazes ligjore te kerkese-padise si dhe perpos shpjegimeve te palëve ndërgjyqëse çmon se referuar Nenit 6 të K. Pr. Civile percaktohet se: “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”. Nga ana tjetër Neni 16/1 përcakton se “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore..... Gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës. Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.”. Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre.

Perpos kesaj referuar parimeve proceduriale te siperperemendura, pare ne harmoni dhe me konkluzionet e vendimin unifikues te Kolegejeve te Bashkuara te Gjykates se Larte Nr. 3 dt. 29. 03. 2012 lidhur me bazen ligjore te kerkese-padise gjykata nisur nga parimi *ius novit curia* (gjykata e njeh ligjin) çmon se ne rastin konkret shkaku ligjor i kerkese-padise eshte i qarte dhe i kuptueshem ne lidhje me objektin e kerkimit te pretenduar. Sipas ketij vendimi eshte unifikuar se : *gjykata e zbulon shkaku e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi*

në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesë-padisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojtë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesë-padisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar.

Nisur nga keto percaktime procedurale, gjykata në analize të pretendimeve dhe prasimeve të paleve ndërgjyqese dhe provave të administruara në gjykim çmon se kerkese-padia duhet pranuar si e tillë për arsyet e mëposhtme:

Në nenin 140 i Ligjit Nr. 9947 dt. 07.07.2008 “Për pronesine Industriale” (në fuqi në kohën e ngritjes së kerkese-padisë) percakton se:

“1. Çdo shenjë ose kombinim shenjash, që paraqitet grafikisht dhe që shërben për të dalluar mallrat apo shërbimet e një personi fizik ose juridik, nga ato të një personi tjetër fizik ose juridik, është markë që përfaqëson ato mallra ose shërbime, me kusht që të përmbushen kërkesat e neneve 141 deri në 143 të këtij ligji (në vijim do të quhet “markë”).

2. Përbëjnë marka shenjat e mëposhtme:

a) fjalët, përfshirë emrat personalë, shkronjat, numrat, shkurtime;

b) shenjat figurative, përfshirë vizatimet;

c) format dy ose tredimensionale, format e mallrave dhe/ose ambalazhimi i tyre;

ç) kombinimet e ngjyrave e të dritë-hijeve, si dhe ngjyrat në vetvete;

d) çdo kombinim i shenjave, të përmendura nga shkronjat “a” deri në “ç” të kësaj pike.

3. Markat regjistrohen vetëm nëse ato mund të paraqiten grafikisht. Kjo lidhet veçanërisht me lloje të veçanta markash, si zëri dhe sinjalet e dritës, por jo vetëm me këto.”

Neni 143 i Ligjit percakton se: “1. Marka nuk mund të mbrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme.

2. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur:

a) është e njëjtë me një markë të mëparshme dhe mallrat e shërbimet, për të cilat është aplikuar ose regjistruar ajo, janë identike me mallrat ose shërbimet, për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme;

b) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike ose të ngjashme dhe kur, për shkak të njëjlojshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkaktimit të konfuzionit të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes me markën e mëparshme;

c) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, edhe kur është për t’u regjistruar ose është regjistruar për mallra apo shërbime, që nuk janë të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar marka e mëparshme, kur marka e mëparshme ka një reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe përdorimi ose regjistrimi i markës në fjalë, pa shkak të arsyeshem, fiton prioritet të padrejtë ose dëmton natyrën dalluese apo emrin e mirë të markës së mëparshme.

3. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nëse cenon të drejtat e mëparshme, të fituara, si:

a) të drejtën e emrit tregtar, me kusht që ky emër ose pjesa thelbësore e tij të jetë e njëjtë apo e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet, dhe që pronari i emrit tregtar të prodhojë apo të sigurojë përkatësisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet;

b) të drejtën e një personi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e të cilit është e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet;

c) të drejtat e pronësisë industriale, përfshirë emrat e varieteteve të mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe të treguesve gjeografikë;

ç) të drejtat e autorit të një

vepre ose të një pjese të saj, me kusht që ajo të jetë e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të mbrohet.

4. Marka nuk mbrohet, nëse është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të regjistruar, për mallra apo shërbime të njëjta ose të ngjashme dhe nëse vlefshmëria e saj ka mbaruar për shkak të mbarimit të afatit të mbrojtjes, për një periudhë gjashtëmujore nga mbarimi i këtij afati.

5. Markë e mëparshme, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet:

a) marka, me një datë aplikimi për regjistrim më të hershme sesa data e aplikimit për regjistrim e një marke tjetër tregtare, duke pasur parasysh, kur është rasti, pretendimin për prioritet për atë markë, sipas nenit 147 të këtij ligji;

b) marka, që është regjistruar më parë, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë;

c) aplikimi për një markë, sipas përcaktimit të shkronjave "a" e "b" të kësaj pike, në varësi të regjistrimit të tyre;

ç) marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, te publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit, në përputhje me parashikimet e DPPM-së dhe të autoriteteve ndërkombëtare."

Neni 156 i Ligjit PI, paragrafi 2, parashikon: "Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij: a) një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka; b) një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare; c) një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshem, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës".

Neni 184/a i ligjit percakton se: 1. E drejta për të ngritur padi në gjykatë për shkelje të të drejtave, sipas këtij ligji, i përket:

a) pronarit të një patente, disenjoje ose markë të regjistruar;

b) përdoruesit të autorizuar të një marke kolektive ose treguesi gjeografik;

c) mbajtësit të një licence ekskluzive për një patentë ose aplikimi për patentë, në përputhje me kreun XXX, si dhe mbajtësit të një licence për një disenjo industriale ose marke, në përputhje me nenet 129 dhe 163, të këtij ligji;

ç) pronarit të një marke të mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, në përputhje me shkronjën "ç", të pikës 5, të nenit 143, të këtij ligji.

2. Pronari i një patente ose i një aplikimi për patentë ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë kundër çdo personi, që ka shkelur, po shkel ose rrezikon të shkelë të drejtat mbi patentën. Megjithatë, gjykata mund të mos vendosë në themel për çështjen, derisa të publikohet patenta e dhënë.

3. Kur i licencuari ka një licencë ekskluzive mbi një patentë ose aplikim për patentë, ai ka të drejtë të fillojë proces gjyqësor, nëse pronari i patentës ose i aplikimit për patentë, pas njoftimit zyrtar nga i licencuari, nuk fillon procesin gjyqësor kundër shkeljeve, brenda një periudhe të arsyeshme kohe. Nëse licenca e patentës është joekskluzive, i licencuari mund të fillojë procesin gjyqësor kundër shkeljes vetëm nëse pronari i saj ose aplikuesi për patentë jep pëlqimin. Pronari i patentës ose aplikuesi për patentë ka të drejtë të marrë pjesë në procesin gjyqësor kundër shkeljes së fi lluar nga i licencuari. Në rastin kur gjykimi ndaj shkeljeve fillohet nga pronari i patentës, i licencuari ka të drejtë të marrë pjesë në gjykim si person i tretë.

Neni 184/a i ligjit percakton se: 1. Personat e përmendur në nenin 184/a, të këtij ligji, kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kundër çdo personi, që shkel të drejtat e tyre për të kërkuar:

a) ndalimin e veprimeve të mëtejshme që përbëjnë shkelje të të drejtave;

b) heqjen ose bllokimin e objekteve, që përbëjnë shkelje të të drejtave nga qarkullimi civil ose shkatërrimin e këtyre objekteve;

c) heqjen ose bllokimin e mjeteve të përdorura ekskluzivisht ose pothuajse ekskluzivisht për krijimin apo prodhimin e produkteve, që përbëjnë shkelje ose shkatërrimin e tyre;

ç) publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike me shpenzimet e personit që ka kryer shkeljen, sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata.

2. Gjykata urdhëron zbatimin e masave të parashikuara në pikën 1, shkronjat "b" dhe "c", të këtij neni, me shpenzimet e shkelësit, përveç kur ka arsye të veçanta për të vendosur ndryshe. Në shqyrtimin e kërkesës për marrjen e masave të parashikuara në pikën 1, shkronjat "b" dhe "c", gjykata vlerëson proporcionalitetin midis rëndësisë së shkeljes dhe masës së urdhëruar, si dhe interesat e palëve të treta.

3. Masa e parashikuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, mund të merret edhe ndaj një ndërmjetësi, shërbimet e të cilit përdoren nga një palë e tretë për të shkelur një të drejtë të pronësisë industriale.

4. Padia kundër shkeljes së të drejtave duhet të depozitohet në gjykatë, brenda tre vjetëve nga data kur paditësi merr dijeni për shkeljen dhe shkelësin.

Neni 184/2 i ligjit percakton se: "Përbën shkelje të së drejtës, sipas rastit, çdo përdorim, kufizim, imitim ose bashkëshoqërim i paautorizuar i disenjos së regjistruar, markës apo treguesit gjeografik, si dhe çdo veprim tjetër që cenon të drejtat e pronarit, sipas neneve 127, 156 dhe 178, të këtij ligji. I njëjti rregull zbatohet edhe për disenjon, markën apo

*treguesin gjeografik të depozituar në DPPM, për të cilin është bërë kërkesë për regjistrim, sipas këtij ligji.”*

“Markat e mirënjohura” mbrohen nëpërmjet zbatimit të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale (1883) e ndryshuar, (Konventa e Parisit) dhe Neni 16 i Marrëveshjes mbi Aspektet Tregtare të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (TRIPs). Qëllimi i Nenit 6bis të Konventës së Parisit është të mbrojë markat tregtare të mirënjohura. Vendet e saj anëtare i nënshtrohen detyrimit të refuzojnë ose anulojnë regjistrimin e markave tregtare të cilat janë konfuze apo të ngjashme me një markë të mirënjohur, apo/dhe të ndalojnë përdorimin e tyre. Parakusht për mbrojtjen e një marke të mirënjohur është ngjashmëria e produktit. Megjithatë, mbrojtja shtrihet përtej ngjashmërisë së produktit, kur përdorimi i markës tregtare do të shfaqte një lidhje midis produkteve dhe pronarit të markës tregtare të mirënjohur, e cila ndoshta do ti shkaktonte dëm pronarit të markës tregtare.

Pavarësisht se konkurrenca e pandershme nuk është trajtuar në mënyrë të gjerë dhe ezauruese në legjislacionin Shqiptar, Kodi Civil ka përcaktuar elementet për të garantuar mbrojtjen ligjore të shënjave dalluese dhe të drejtave të patentës, dhe në nenin 638 parashikon se, *“veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që: (i) përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti; (ii) trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit; (iii) përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit”*.

Për më tepër, neni 639 parashikon se: *“Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcakton masat e nevojshme me qëllim që të zhduken pasojat. Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë dëmin”*.

Lidhur me pretendimin se marka "\*\*\*\*" është markë e mirënjohur argumentohet se, mbështetur në nenin 6 bis të Konventës së Parisit dhe në ligjin Nr. 9947 "Per Pronësinë Industriale" i ndryshuar me ligjin Nr. 10/2013, datë 14. 02. 2013 dhe ligjin Nr. 55/2014, datë 29. 05. 2014, nenit 143, pika 5, germa ç), përcakton se: *"Në datën kur "\*\*\*\*" ka aplikuar pranë DPPI për të fituar të drejta industriale mbi markën "\*\*\*\*", shoqëria "\*\*\*\*" ka pasur të drejta të meparshme mbi këtë markë"*.

Pretendimi mbi "te drejta të meparshme", në datën kur "\*\*\*\*" ka dorezuar pranë DPPI aplikimin për regjistrimin e markës "\*\*\*\*", mbështetet në :

*-faktin që marka "\*\*\*\*" ka pasur karakter dallues dhe tregtohej rregullisht në tregun Shqiptar që prej muajt janar të vitit 2010, me origjinë tregtare kompanie turke "\*\*\*\*";*

*-pretendimin se, kjo markë gezonte reputacionin e një markë e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit te publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit dhe reklamimit.*

Neni 143 i ligjit Nr. 9947/2008 me ndryshimet, përcakton se: *“5. Markë e mëparshme, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet: ....ç) marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e*

*mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit."*

Kriteret ligjore të percaktuara me sipër para në raport me Konventën që ti japin një markë statusin "markë e mirënjohur" kërkojnë nga gjykata që vlerësimin e tyre ta bëjë në përputhje me kuptimin dhe qëllimin që kanë në vetvete këto terma të përdorura në ligj para në raport me rrethanat konkrete. Kështu koncepti "përdorim" nënkupton për gjykatën *se pari* përdorimin e saj minimalisht në një grup të caktuar të interesuarish dhe maksimalisht për publikun e gjere dhe *se dyti* kohezgjatja e këtij përdorimi përben kriter tjetër vlerësues për gjykatën për dhenien e këtij statusi. Koncepti i "reklamimit ose publikimit" lidhet me evidentimin e kesaj markë nepermjet formave të ndryshme të të bërit publike si reklama, spote publicitare, postera, flete-palosje, etj. U provua gjyqesisht se kjo markë tregtare është e mirënjohur në tregun shqiptar për sa kohë që ajo si e tillë është tregtuar që nga viti 2010 e në vijim nga shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k.. Nga pala paditese përpos gjithë praktikave, kontratave të distribucionit apo të reklamave të sjella ndër vite lidhur me importimin e këtyre produkteve në tregun shqiptar nga shoqëria pronare e saj, u provua edhe fakti i qenies së kesaj markë dhe produktit që ajo tregton si mall konsumi jetik i përditshëm nga mbare popullata (konsumatori).

*Neni 6 bis i Konventës së Parisit përcakton se: "1. Shtetet e Unionit marrin përsipër, për shkak të detyrës nëse legjislativi i tyre e lejon, ose me kërkesë të palës së interesuar, të refuzojnë ose të anullojnë regjistrimin, dhe të ndalojnë përdorimin, e një markë që konsiston në riprodhim, imitim, ose përthim, me qëllim që të shkaktojë konfuzion, të një markë që konsiderohet nga autoritetet kompetente të shtetit të regjistruar ose e mirënjohur në atë shtet në emër të një personi që gëzon të drejtat sipas kesaj konvente dhe përdoret për mallra identike apo të ngjashme. Këto dispozita aplikohen edhe kur pjesa esenciale e një markë konsiston në riprodhim të një markë të mirënjohur ose në imitim me qëllim të krijojë konfuzion në lidhje me të."*

Po kështu për të provuar se marka "\*\*\*\*" është markë e mirënjohur mbështetur në rekomandimet e Asamblesë së Konventës së Parisit "Për mbrotjen e pronësive industriale", në të cilën Shqipëria ben pjesë që në vitin 1995 dhe të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës Botërore për Pronësi Intelektuale në të cilën Shqipëria ben pjesë që në vitin 2003, ku sipas këtyre citohet se: *përcaktimi nëse një markë është e mirënjohur mbështetet në faktoret e listuar në vijim, të cilët mund të konsiderohen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, ose të kombinuar mes tyre.*

- *Shkalla e njohjes së markës në sektorin publik përkatës;*
- *Kohëzgjatja, përhapja dhe zona gjeografike e përdorimit të markës;*
- *Kohëzgjatja, përhapja dhe zona gjeografike e promovimit të markës, ku përshihen reklamimet ose publiciteti dhe prezantimi i markës, në panairë ose ekspozita, për mallrat dhe/ose shërbimet për të cilat marka aplikohet;*
- *Kohëzgjatja dhe zona gjeografike e çdo regjistrimi, dhe /ose çdo aplikimi për regjistrim, të markës, në masën që ato pasqyrojnë përdorimin ose njohjen e markës;*
- *Vlerat që lidhen me markën.*

Nisur nga Rekomandimet e Asamblese se Konventes se Parisit, marka "\*\*\*\*" me origjine tregtare "\*\*\*\*", ploteson kriteret per te fituar statusin "markë e mirenjohur", bazuar në percaktimin e nenit 6 bis të Konventës së Parisit, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit dhe reklamimit, parashikuar dhe nga ligji nr 9947,"Per Pronesine Insdustriale", neni 143, pika 5, germa ç).

Faktoret që ndihmojnë në percaktimin e markës si markë e mirenjohur jane :

- a) *shtrirja kohore prej me shumë se shtate vitesh në tregun shqiptar.*
- b) *perdorimi e mallrave me markën "\*\*\*\*" nga konsumatorët që prej 16. 01. 2010.*
- c) *perhapja dhe shtrirja gjeografike e shitjeve dhe rrjedhimisht konsumimi i këtyre te produkteve në pothuajse gjithë qytetet e Shqipërisë.*
- d) *numri i shitjeve te produkteve dhe perfitimet që nxjerr kompania shitese dhe shperndarese.*
- e) *njohja dhe shtrirja gjeografike që kalon kufijte e Shqipërisë, pasi ajo shitet edhe në shtete te tjera si Turqia, Iraku, Azerbajxhan, Turkmenistan, Egjipt, Butan, Jordani, Siri, Ukranina etj.*
- f) *marka "\*\*\*\*" është e regjistruar dhe ka fituar te drejta industriale në Turqi dhe Irak nepermjet aplikimeve lokale.*
- g) *marka "\*\*\*\*" është e regjistruar dhe ka fituar te drejta industriale nepermjet aplikimit nderkombetar per regjistrim marke në WIPO per shtetet Shqiperi, Azerbajxhan, Bosnje -Hercegovine, Gjeorgji, Republika Ismamike e Iranit, Kazakistan, Maqedoni, Turkmenistan dhe Ukraine.*

Mallrat e klases 3, sipas Klasifikimit Nderkombetar te Nices, me marken "\*\*\*\*" prodhohen nga shoqeria turke "\*\*\*\*", e cila ka autorizuar kompanine "\*\*\*\*" sh.p.k. per shpërndarjen dhe shitjen e produkteve të saj me markën "\*\*\*\*" brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nepermjet marreveshjes se bashkëpunimit të firmosur nga dy palët me datë 16. 01. 2010. Kjo marrëveshje është rinovuar në 16. 01. 2016 dhe kompania "\*\*\*\*" sh.p.k. vazhdon te shperndaje produktet me markë \*\*\* brenda territorit shqiptar.

Kompania "\*\*\*\*" sh.p.k. shperndan dhe tregton keto produkte, qe prej janarit te vitit 2010, në pothuajse te gjithë qytetet e Republikës së Shqipërisë dhe ky fakt vertetohet lehtesisht nga "faturat tatimore të shitjes midis "\*\*\*\*" sh.p.k. me dyqanet dhe supermaketet në qytete të ndryshme të Shqipërisë.

Vërehet se gjate kesaj periudhe shtate vjecare, numri i shitjeve të këtyre mallrave dhe sasia e mallrave te shitura kane ardhur duke u rritur me kalimin e kohes dhe se shtrirja gjeografike e ketij produkti ka ardhur duke e zgjeruar. Kjo vertetohet lehtesisht nga detajet e shenuara ne:

- faturat tatimore te shtijes leshuar nga komania \*\*\* sh.p.k.*
- faturat e leshuara nga kompania \*\*\* në emer te kompanise shperndarese,*
- deklarata doganore leshuara nga pikat doganore në Shqiperi.*

U provua ne gjykim se marka "\*\*\*\*" është bere e njohur per publikun edhe nepermjet promovimit që shoqeria "\*\*\*\*" sh.p.k., ne prill të vitit 2016, me iniciativen e saj ka bere reklamim të produkteve "\*\*\*\*" në ambiente të hapur publik siç është tregu Gostim në Elbasan me datë 17 prill 2016; në Cerrik me datë 21 prill 2016 dhe në fshatin Mollas të Elbasanit.

Marka "\*\*\*\*" eshte regjistruar nepermjet Organizates Nderkombetare te Pronesise Industriale (WIPO) dhe mban numer regjistrimi \*\*\* dhe date aplikimi 13. 03. 2017. Regjistrimi i markes eshte kerkuar në shtetet: Shqiperi, Azerbajxhan, Bosnje-Hercegovine, Gjeorgji, Republika Islamike e Iranit, Kazakistan, Maqedoni, Turkmenistan dhe Ukraine.

Një provë e rëndësishme që verteton se marka "\*\*\*\*" ekziston prej vitesh në Shqiperi dhe nuk ka origjine tregtare \*\*\* (\*\*\*\*-), i cili është edhe aplikanti per regjistrimin e markës prane DPPI, është pohimi i vet z. \*\*\* gjate seancave te zhvilluara (pohim ky i cili ne kuptim te Nenit 214 te K. Pr. Civile vleresohet njelloj me gjithë provat e tjera), sipas te cilit : "Marka "\*\*\*\*" me pelqeu dhe meqënëse ishte e lire pranë Drejtorise se Pergjithshme të Patentave dhe Markave, une bera kërkesë për regjistrimin e markës "\*\*\*\*";

... "Është zotesia ime që të shfrytezoj hapesirat ligjore per regjistrimin e markës".

Gjithashtu i padituri ka rikonfirmuar se kishte dijeni që marka "\*\*\*\*" ekzistonte dhe nuk ishte e regjistruar prane institucioneve përgjegjëse dhe per kete arsye ka ndermarre veprime, me vetdije të plotë, për të fituar të drejta industriale mbi markën "\*\*\*\*".

-Po keshtu, sa me siper pyetjes se drejtuar nga pala paditese : "Pse kerkoni te regjistroni nje marke per te cilen kishit dijeni që ishte në tregun shqiptar" i padituri i eshte pergjigjur: "Sepse nuk ishte e regjistruar".

Lidhur me pretendimin se i padituri po zhvillon konkurrence te pandershme në parashikimet e nenit 638 të Kodit Civil percaktohet se: "Në varësi të dispozitave që kanë lidhje me mbrojtjen e shënjjave dalluese dhe të drejtave të patentës, veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që: 1. përdor emrat ose shënjjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti; 2. trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit; 3. përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit."

I padituri gjate seancave gjyqesore, ka pohuar se nuk tregon produkte me markën "\*\*\*\*", por gjithsesi ky pohim nuk verteton se ai realisht nuk i shet keto produkte.

Nisur nga argumenti se "një person fizik apo juridik aplikon prane DPPI per regjistrim markë në rastet kur është duke e perdorur ose synon t'a perdor ate" dhe parashikimi i nenit 174 te ligjit Nr. 9947 te Pronesise Industriale, "Zhvlerësimi i markës" si rezultat i mosperdorimit, per gjykaten arrihet ne perfundimin se i padituri minimalisht ka synim që te tregtoje produktet e klases 3 sipas klasifikimit te Nices me markën "\*\*\*\*".

Kete arsyetim i padituri e pranoi dhe miratoi gjate shqyrtimit gjyqesor, duke pohuar se : "Teknika ime eshte që fillimisht te regjistroj markat dhe me pas ti nxjerr në treg".

Bazuar në pohimet e lartpermendura te te paditurit dhe ne faktin që ai ka aplikuar prane DPPI per regjistrimin e markës "\*\*\*\*" në kushtet ku:



- I padituri kishte dijeni dhe ishte i vetedijshem se marka "\*\*\*\*" ekziston në tregun shqiptar;

- Marka "\*\*\*\*" është identike me markën që shoqëria "\*\*\*\*" tregtohen prej date 16. 01. 2010;

- Pranon që strategjia që ndjek është fillimisht regjistrimi i markes dhe me pas perdorimi duke i nxjerr në treg;

arrihet në konkluzionin se plotesohen kriteret e konkurrencës së pandershme të parashikuara nga pika 1 dhe 3, të nenit 638 të Kodit Civil, pasi i padituri ka ndermarre veprime që bien ndesh me parimet e ndersmerise profesionale si dhe me vetedije të plote synon të perfitojë të drejta të pamërituara duke demtuar veprimtarine e kompanisë "\*\*\*\*" si dhe të distributorit "\*\*\*\*" shpk.

Sa me sipër, gjykata konkludon se, në datën 26. 07. 2016, kur aplikanti \*\*\* ka depozituar pranë DPPI kërkesën për regjistrimin e markës "\*\*\*\*", marka ekzistonte në tregun shqiptar që prej datës 16. 01. 2010 dhe ka origjinë tregtare kompanisë "\*\*\*\*".

Në bazë të ligjit Nr. 9947, "Për Pronesinë Industriale", nenit 141 në datën kur \*\*\* ka aplikuar për regjistrim marke pranë DPPI, marka "\*\*\*\*" me origjinë tregtare kompanisë "\*\*\*\*", ka pasur karakter dallues në treg, në krahasim me markat e produkteve të tjera të të njëjtit lloj.

Në datën kur \*\*\* ka aplikuar për regjistrim marke pranë DPPI, Marka "\*\*\*\*" ka pasur "të drejta të mëparshme" të fituara si rezultat i përdorimit të gjatë në treg, publikimit dhe reklamimit për sektoreve të caktuar publik siç mund të jenë konsumatorët e këtyre produkteve, kompanitë që kryejnë shpërndarjen e këtyre produkteve dhe sektore të tjera që kanë lidhje me këto produkte.

Në konkluzion të sa më sipër, u provua para gjykates se, i padituri ka pasur dijeni mbi ekzistencën e markës "\*\*\*\*" në tregun shqiptar dhe pasi ka marrë informacion se kjo markë nuk ka një regjistrim të mëparshëm dhe meqenëse "kjo markë i ka pelqyer dhe ishte e lire", ai ka ndermarre veprime për të fituar pronesinë e markes "\*\*\*\*" dhe për të legjitimuar përdorimin e saj.

Gjate hetimit gjyqësor i padituri ka bërë pohime që çojnë në përfundimin se edhe vet ai është i vetedijshëm dhe e pranon që "\*\*\*\*" nuk është pronari i vertetë i markës "\*\*\*\*", për të cilën ai ngre pretendime për të fituar pronesinë industriale.

Veprimet e ndermarra nga "\*\*\*\*" në lidhje me aplikimin për regjistrimin e markës "\*\*\*\*" në emër të "\*\*\*\*", plotesojnë kushtet e parashikuara nga neni 638 pika 1 dhe 3 të Kodit Civil, për zhvillimin e konkurrencës së pandershme.

Për sa më sipër u analizua gjykata çmon se kërkesë-padia është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

#### **PER KETO ARSYE :**

Gjykata bazuar në Nenet 126, 306-308 e vijues të K. Pr. Civile,

#### **VENDOSI :**

1. Pranimin e kërkesë-padisë.
2. Detyrimin e te paditurit “\*\*\*\*”-\*\*\*, njohur me emrin tregtar “\*\*\*\*” qe ne kuader te konkuresces se pandershme: te nderprese aktivitetin e mundshem te prodhimit, shperndarjes se produkteve ne treg te markes “\*\*\*\*”, te ndaloje perdorimin e markes “\*\*\*\*” ne veprimtarine tregtare te tij, te heq nga tregu dhe te bllokoje shperndarjen e metejshme te produkteve qe mund te ekzistojne apo qe mund te prodhohen ne vijimesi nga i padituri.
3. Detyrimin e te paditurit te heq dore nga kerke sa per te fituar te drejta industriale mbi marken “\*\*\*\*”.
4. Percaktimin e statusit te markes “\*\*\*\*”, si “marke e mirenjohur”.
5. Detyrimin e te paditurit qe te publikoje vendimin ne dy media publike per nje periudhe kohore dy ditore, me shpenzimet e tij.
6. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te te paditurit.
7. Kunder ketij vendimi lejohet te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve, afat ky qe fillon nga e nesermja e shpalljes se tij.
8. **U shpall sot me date 18. 07. 2017 ne Tirane.**

**SEKRETARE**

**GJYQTAR**

**LUSJANA FEZOLLARI  
POLLOZHANI**

**ERVIN**

**Shpenzimet gjyqësore**

Taksë padie	*** lekë
<u>Shpenzime njoftimi</u>	*** <u>lekë</u>
<b>Totali</b>	<b>***lekë</b>